



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.05.2023

Nr: 103

Ora: 13:40

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 24, DATË 10.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik dhe ndaj

z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e shtatë veprimtarive publike nga gjashtë institucione publike, konkretisht bashkitë Cërrik, Krujë, Devoll, Fier, Lezhë dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, duke mosraportuar këto aktivitete në ndërfaqen e KQZ-së.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionet shtetërore përkatëse. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj personave përgjegjës përkatës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Cërrik dhe bashkisë Devoll, në masën 5.000 (pesë mijë) lekë.
3. KAS-i caktoi me short z. Ilirjan Rusmali relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 24, datë 10.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 12.05.2023, ora 13:30.
4. Seanca e datës 12.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Cërrik dhe bashkisë Devoll të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 24, datë 10.05.2023 të Komisionerit;
- Vendimin nr. 469, datë 09.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 174 ID, 175 ID, 213 ID, 214 ID, 215 ID, 218 ID, 233 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”;
- Denoncimet e regjistruara me nr. 174 dhe 175 ID ndaj bashkisë Cërrik;
- Denoncimi i regjistruar me nr. 213 ID ndaj bashkisë Devoll.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Komisioneri ka marrë në shqyrtim 7 denoncime (denoncimet e regjistruar me numër **174 ID, 175 ID, 213 ID, 214 ID, 215 ID, 218 ID, 233 ID**) dhe ka paraqitur kërkesë për vendosjen e sanksionit administrativ për 3 denoncime, për denoncimet **nr. 174 ID** dhe **nr. 175 ID** ndaj bashkisë Cërrik dhe denoncimin **nr. 213 ID** ndaj bashkisë Devoll. Komisioneri ka pushuar procedimin për denoncimin **nr. 214 ID** ndaj bashkisë Fier, denoncimin **nr. 215 ID** ndaj bashkisë Krujë, denoncimin **nr. 218 ID** ndaj bashkisë Lezhë dhe denocimin **nr. 233 ID** ndaj Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.
2. KAS-i gjen të plotë dhe të referuar saktë kërkesën e Komisionerit për marrjen e masës administrative gjorbë ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik, bazuar në arsyetimin se *“veprimtaritë publike objekt i denoncimeve të regjistruara me nr. 174 ID dhe 175 ID, janë raportuar për t’u kryer në data të ndryshme, nga ato që faktikisht janë kryer. Nëse gabimet e kryera nga ana e personit përgjegjës për raportim do të ishin gabime materiale, raportimi do të ishte në shkelje të afatit 5 (pesë) ditor, të përcaktuar nga neni 92, të Kodit Zgjedhor”*.

3. Raportimi i pasaktë, i pavërtetë ose me mangësi i veprimtarive publike është në kundërshtim me qëllimin që ndjek mekanizimi i raportimit. Mekanizimi është ngritur në shërbim të transparencës së veprimtarisë institucionale dhe të monitorimit nga shoqëria të kësaj veprimtarie. Transparenca dhe monitorimi janë instrumentat e parashikuar nga ligji për të garantuar neutralitetin në zgjedhje, gjegjësisht mbrojtjen nga keqpërdorimi i burimeve publike. Deklarimi i veprimtarisë në një ditë të caktuar të periudhës së monitorimit dhe zhvillimi i saj në një ditë tjetër, edhe sikur të mos bëhen me keqdashje, formojnë praktikë të dëmshme dhe të papranueshme.
4. Po kështu, konkluzioni i Komisionerit se *“veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me nr. 213 ID përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”* është i bazuar në prova dhe ligj. Prandaj, kërkesa e Komisionerit për marrjen e masës administrative ndaj z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll duhet të pranohet nga KAS-i.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin me një ndryshim të kërkesës së Komisionerit.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik, gjobë në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

4. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

U shpall sot më datë 12.05.2023.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar